



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 17 shkronja k) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/l-049, nenet 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Rregulloren (komunale) për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte nr.prot.01/111-400 të datës 28 maj 2012 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren nr.prot.01/172-400 të datës 27 shtator 2012, si dhe në bazë të Programit Trevjeçar të Banimit 2019-2021 në Komunën e Podujevës i miratuar me Vendimin nr.prot.01-360/01-0060753/19 të datës 29 korrik 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021, miratoi këtë,

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim ndahen mjete financiare në shumë 50,000.00 €, me destinim për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1, do të jenë në dispozicion për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit dhe të njëjtat mund të barten në llogarinë e Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” me të cilën Komuna e Podujevës ka lidhë Marrëveshje Bashkëpunimi për bashkëfinancim.

Neni 3

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi buxhetor 200.

Neni 4

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot.01-400/01-0035819/21
Podujevë,
29 prill 2021

